



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-05

**Prokurori kundër Salih Mustafës**

**Vendosi:** Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, Gjykatës Rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 27 maj 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i Redaktuar Publik i**

**Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorisë për Paraqitje të Kundërprovave**

---

**T'i njoftohet:**

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtjes së të akuzuarit**

Julius von Bone

**Zyrës Administrative**

Shefit të Zyrës për Mbrojtjen dhe  
Mbështetjen e Dëshmitarëve

**Mbrojtëses së viktimave**

Ani Pues

**TRUPI GJYKUES I** (Trupi Gjykses) lëshon këtë vendim në lidhje me kërkesën e Prokurorisë për paraqitje të kundërprovave.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 maj 2022, Trupi Gjykses i kërkoi Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) që të dorëzojë kërkesë për paraqitje të kundërprovave, nëse ka, deri më 24 maj 2022, me përgjigjet e Mbrojtjes së Salih Mustafës (Mbrojtja) dhe mbrojtëses së viktimave, nëse kanë, deri më 26 maj 2022.<sup>1</sup>
2. Më 24 maj 2022, ZPS-ja parashtrroi “Kërkesën e Prokurorisë për Paraqitje të Kundërprovave” (Kërkesa).<sup>2</sup>
3. Më 26 maj 2022, Mbrojtja parashtrroi “Përgjigjen e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Paraqitje të Kundërprovave” (Përgjigjja).<sup>3</sup>
4. Mbrojtësja e viktimave nuk parashtrroi përgjigje.

## II. PARASHTRIMET

5. ZPS-ja kërkon leje nga Trupi Gjykses të paraqesë kundërprova shtesë, në pajtim me rregullat 127(2)(d) dhe 133 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja), konkretisht: (i) dëshminë gojore të dëshmitarit [REDAKTUAR] dhe materialin përkatës (dëshmia gojore); dhe (ii) prova shkresore si, ndër të tjera, raporte nga organizata ndërkombëtare, artikuj nga organe të mediave në Kosovë dhe nga agjencitë ndërkombëtare të shtypit (provat

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-05, Transkripti i seancës, 19 maj 2022, publik, f. 4405, rreshti 17 deri f. 4406, rreshti 12.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-05, F00416, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Paraqitje të Kundërprovave*, 24 maj 2022, konfidencial.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-05, F00423, Mbrojtja, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së ZPS-së për Paraqitje të Kundërprovave*, 26 maj 2022, konfidencial.

shkresore).<sup>4</sup> ZPS-ja parashtron se dëshmia gojore nuk mund të parashikohej përmes ushtrimit të zellit të duhur, sepse dëshmitari [REDAKTUAR] kontaktoi ZPS-në vetëm pas mbylljes së paraqitjes së provave të ZPS-së, me rastin e dhënies së dëshmisë prej dëshmitarit të Mbrojtjes WDSM-200.<sup>5</sup> ZPS-ja gjithashtu parashtron se e njëjta gjë vlen edhe për provat shkresore, për arsye se nevoja për paraqitje të kundërprovave erdhi vetëm pas dhënies së dëshmisë së dëshmitarit të ZPS-së W04849 dhe pasi disa dëshmitarë të Mbrojtjes dëshmuuan për fluksin e popullatës në kohën e akuzave.<sup>6</sup> ZPS-ja gjithashtu pretendon se provat shkresore janë të rëndësishme për identifikimin e anëtarëve të pretenduar të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, për besueshmërinë dhe vërtetësinë e dëshmisë së dëshmitarit [REDAKTUAR] dhe për besueshmërinë e dëshmitarit të Mbrojtjes WDSM-200.<sup>7</sup> Sa u përket provave shkresore, ZPS-ja pretendon se do të jenë të rëndësishme për kundërshtimin e provave të Mbrojtjes në lidhje me alibinë e të akuzuarit, që lidhet me kohën kur popullata lëvizte nga Prishtina.<sup>8</sup> Së fundi, ZPS-ja pretendon se provat e propozuara janë të rëndësishme dhe provuese dhe se paraqitja e tyre është në interes të drejtësisë dhe do të ndihmojë në përcaktimin e së vërtetës.<sup>9</sup>

6. Mbrojtja kundërshton Kërkesën.<sup>10</sup> Ajo parashtron se dëshmia gojore nuk duhet paraqitur, sepse Mbrojtja nuk pati mundësinë që të ballafaqonte dëshmitarin [REDAKTUAR], që shkel të drejtën për gjykim të drejtë.<sup>11</sup> Në rast se ZPS-së i lejohet paraqitja e kësaj dëshmie, Mbrojtja pretendon se dëshmitari [REDAKTUAR] duhet të ftohet të dëshmojë për çështjet që ngriti me ZPS-në.<sup>12</sup> Mbrojtja gjithashtu pretendon se provat shkresore: (i) janë të përgjithshme ; (ii) mund të ishte përdorur gjatë marrjes

---

<sup>4</sup> Kërkesa, para. 3-4, 7.

<sup>5</sup> Kërkesa, para. 5.

<sup>6</sup> Kërkesa, para. 5.

<sup>7</sup> Kërkesa, para. 3.

<sup>8</sup> Kërkesa, para. 4.

<sup>9</sup> Kërkesa, para. 6.

<sup>10</sup> Përgjigja, para. 37-40.

<sup>11</sup> Përgjigja, para. 10-14, 17.

<sup>12</sup> Përgjigja, para. 15.

në pyetje të dëshmitarëve të Mbrojtjes, e jo në këtë fazë të procesit; dhe (iii) dhe nuk japin hollësi se me cilat pjesë të dëshmive të dëshmitarëve të Mbrojtjes kanë lidhje.<sup>13</sup> Rrjedhimisht, Mbrojtja pretendon se pranimi i këtij materiali, pa iu dhënë Mbrojtjes mundësia për ta kundërshtuar, është i padrejtë.<sup>14</sup>

### III. DISPOZITA LIGJORE PËRKATËSE

7. Trupi Gjykses mbështetet në nenin 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullat 127(2)(d) dhe 133 të Rregullores.

### IV. ANALIZË

8. Fillimisht, Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja kishte mundësidhe duhej të kishte parashtruar, në më shumë hollësi, vëllimin e materialit që synon të paraqesë si kundërprova, konkretisht në lidhje me provat shkresore. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se Mbrojtja, në Përgjigjen e saj, paraqet argumente në lidhje me pranueshmërinë e materialit, ndërsa vendimi aktual thjesht ka të bëjë me lejen e ZPS-së për t'ia paraqitur materialin Mbrojtjes, mbrojtëses së viktimave dhe Trupit Gjykses. Varet nga Trupi Gjykses nëse ky material do të shqyrtohet për qëllime të aktgjykimit të tij, në përputhje me sistemin e miratuar për çështjen gjyqësore aktuale.<sup>15</sup>

9. Në lidhje me materialin, Trupi Gjykses vëren se si dëshmia gojore ashtu edhe provat shkresore janë të kufizuara dhe lidhen me aspekte të identifikueshme dhe të ndryshme që kryesisht rrjedhin nga paraqitja e provave prej Mbrojtjes. Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se gjatë paraqitjes së provave të saj, nuk ishte logjikisht e

---

<sup>13</sup> Përgjigjja, para. 25-30.

<sup>14</sup> Përgjigjja, para. 31, 36.

<sup>15</sup> KSC-BC-2020-05, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Parashtrimet dhe Pranueshmërinë e Provave*, 25 gusht, 2021, publik.

mundshme për ZPS-në që të paraqiste këto prova. Gjithashtu, duke pasur parasysh rëndësinë e mundshme të materialit që kërkohet të paraqitet në lidhje me përcaktimin e së vërtetës, Trupi Gjykes gjykon se është në interes të drejtësisë të lejojë ZPS-në të paraqesë këto kundërprova.

10. Në lidhje me shqetësimet që Mbrojtja shprehu për pamundësinë për të kundërshtuar dëshmitarin [REDAKTUAR] dhe materialin përkatës, Trupi Gjykes kujton se vendimi aktual ka të bëjë vetëm me lejen për ZPS-së për paraqitje të këtyre provave. Sikurse shtjellohet më poshtë, Trupi Gjykes synon të thërrasë dëshmitarin [REDAKTUAR] si rezultat i kësaj lejeje. Rrjedhimisht, palëve dhe mbrojtëses së viktimave do t'u lejohet të marrin atë në pyetje lidhur me aspekte të kufizuara që ai ngriti me ZPS-në, sikurse u bë e ditur në Kërkesë.<sup>16</sup>

11. Në lidhje me shqetësimet që Mbrojtja shprehu për provat shkresore, Trupi Gjykes konstaton se ZPS-ja nuk ka mundur të paralajmërojë më herët për kundërshti të mundshme ndërmjet dëshmimeve të dëshmitarëve të Mbrojtjes dhe deklaratave të tyre të mëparshme lidhur me temën e lëvizjeve të popullatës jashtë Prishtine. Trupi Gjykes njëlloj konstaton se provat shkresore nuk janë shumë të përgjithshme, sepse pritet që do të përqendrohen në lëvizjet e popullatës jashtë nga Prishtina midis 24 marsit dhe 6 prillit 1999.

12. Duke pasur parasysh konstatimet më lart, Trupi Gjykes nuk bindet nga argumentet e Mbrojtjes dhe rrjedhimisht miraton Kërkesën.

13. Në lidhje me dëshminë gojore, dhe me synim që të përshpejtohet mbyllja e paraqitjes së provave sipas rregullës 134(a) të Rregullores, Trupi Gjykes cakton të mërkurën, 1 qershor 2022 (dhe të enjten, 2 qershor 2022 si ditë rezervë), si data për dëshminë e dëshmitarit [REDAKTUAR]. Në lidhje me këtë ZPS-ja dhe Mbrojtja do të kenë secila nga një (1) orë për marrje në pyetje dhe mbrojtësja e viktimave do të ketë

---

<sup>16</sup> Kërkesa, para. 3.

30 minuta për marrje në pyetje, në varësi të miratimit të lejes prej Trupit Gjykses për kohë shtesë nëse është e nevojshme. Në qoftë se palët dhe mbrojtësja e viktimave dëshirojnë të paraqesin prova materiale që do të përdoren gjatë dëshmisë së dëshmitarit [REDAKTUAR], duhet t'i dorëzojnë kërkesat e tyre lidhur me këtë deri të premtën, 3 qershor 2022, me përgjigje, nëse ka, që duhen dorëzuar brenda 5 ditësh nga kjo datë.

14. Në lidhje me provat shkresore, Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në të dorëzojë kërkesën për paraqitje të këtij materiali deri të mërkurën, 1 qershor 2022. Gjithashtu, Trupi Gjykses e konsideron të përshtatshme që, në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, të shkurtojë afatin për përgjigje ndaj këtyre kërkesave prej Mbrojtjes dhe mbrojtëses së viktimave, nëse ka, deri të premtën, 3 qershor 2022.

## V. VENDIM

15. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses:

- a. **MIRATON** Kërkesën;
- b. **URDHËRON** ZPS-në të parashtojë kërkesë për pranimit provave shkresore deri të **mërkurën, 1 qershor 2022**;
- c. **NDRYSHON** afatin për përgjigje dhe **URDHËRON** Mbrojtjen dhe mbrojtësen e viktimave të parashtrajnë përgjigje, nëse kanë, në lidhje me kërkesën në (b) më lart, deri të **premtën, 3 qershor 2022**;
- d. **CAKTON** të **premtën, 1 qershor 2022 (të enjten, 2 qershor 2022 si ditë rezervë)**, si data për dëshminë e dëshmitarit [REDAKTUAR];
- e. **URDHËRON** ZPS-në dhe Zyrën për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve, të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për organizimin e dhënies së dëshmisë prej dëshmitarit [REDAKTUAR];

- f. **URDHËRON** palët dhe mbrojtësen e viktimave të paraqesin listat e tyre përkatëse të materialit që do të përdoret gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit [REDAKTUAR] deri të **premtën, 31 maj 2022**; dhe
- g. **URDHËRON** palët dhe mbrojtësen e viktimave të parashtrojnë kërkesa për pranim të materialit përkatës që do të përdoret gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit [REDAKTUAR], e që nuk i është dorëzuar deri tani Trupit Gjykses, deri të **premtën, 3 qershor 2022**, me përgjigje, nëse kanë, që duhet dorëzuar brenda pesë ditësh nga ajo datë.

/nëshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia  
Kryegjykatëse

/nëshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nëshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E hënë, 27 maj 2022

Në Hagë, Holandë.